

## Tryezë e rrumbullakët “Transparenca dhe llogaridhënia në sektorin e shëndetësisë”



Në datën 07.03.2024, në ambientet e Hotel Tirana International, u zhvillua një tryezë diskutimi mbi transparencën dhe llogaridhënien në sektorin e shëndetësisë, ku shoqata “*Together for life*”, prezantoi raportin me temë “Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor – A mbulon skema nevojat reale të kujdesit shëndetësor”, mbështetur nga NED – National Endowment for Democracy.

Në fjalën e saj, Drejtoresha Ekzekutive, znj. Eglantina Bardhi, theksoi se sektori i shëndetësisë vijon të mbetet problematik sa i takon aspektit të financimit të pamjaftueshëm dhe është me rëndësi që rekomandimet e dala të dëgjohen dhe të adresohen nga institucionet përkatëse.

Znj. Aurora Sulçe prezantoi gjetjet kryesore të raportit, ku trajtohen problematikat që lidhen me keq planifikimin, paqëndrueshmërinë e të ardhurave dhe mungesën e transparencës së Fondit të Kujdesit të Detyrueshëm Shëndetësor, duke vënë në dukje një hendek në arritjen e mbulimit universal të nevojave shëndetësore për të gjitha kategoritë e popullsisë dhe duke theksuar nevojën për përmirësimin e efikasitetit në përdorimin e fondeve.

Në fund të raportit janë dhënë rekomandime në lidhje me ndryshimin e modelit të skemës të kujdesit shëndetësor, duke ofruar një qasje më solidare, në kuptim të mbulimit të plotë të të gjithë popullsisë me shërbim shëndetësor dhe jo vetëm të kategorive të kontribuesve; reformimin tërësor të skemës së financimit të spitaleve publike duke u mbështetur në modelin e buxhetimit mbi bazë performance dhe cilësie shërbimi; rritjen e transparencës dhe cilësisë së raporteve të monitorimit; rritjen e transparencës në drejtim të procesit të buxhetimit të fondeve, duke publikuar burimet e financimit përfshirë dhe të ardhurat e veta për çdo spital, shoqëruar dhe me treguesit respektivë cilësorë si, koeficienti i shfrytëzimit të shtretërve, numri i shtrimeve, norma e rishtrimit si dhe rritjen e shpenzimeve publike për shëndetësinë, pasi niveli i ulët prej 10% të shpenzimeve të përgjithshme publike shoqëruar nga niveli i lartë i pagesave nga xhepi prej 56%, krijojnë mbulim financiar të dobët të skemës dhe lënë vend për abuzim dhe informalitet të lartë në këtë sektor.

Kryetarja e Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë në Kuvendin e Shqipërisë znj. Zheni Gjergji si dhe deputeti z. Petrit Vasili, parashtruan problematikat e vazhdueshme lidhur me buxhetin e ulët për kujdesin shëndetësor, duke theksuar keqplanifikimin buxhetor dhe paqartësitë lidhur me ligjin e ri të autonomisë spitalore, duke u ndalur tek nismat e mundshme legjislative për përmirësimin e sistemit.

Përfaqësuesi nga Rrjeti i Koordinatorëve kundër Antikorrupsionit, Z. Fatjon Çajupi, në fjalën e tij u fokusua në misionin e përbashkët për garantimin e praktikave transparente dhe nxitjen e llogaridhënies përmes paraqitjes së rekomandimeve pranë institucioneve, si edhe theksoi masat parandaluese dhe ndërgjegjësuese mbi pasojat e korrupsionit/parregullsive.

Në këtë takim morën pjesë deputetë të Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, përfaqësues nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor, Shërbimi Social Shtetëror, Rrjeti i Koordinatorëve Kundër Korrupsionit, Komisioneri për Mbrojtje nga Diskriminimi, institucione të tjera të pavarura, profesionistë dhe ekspertë të fushës së shëndetit, organizata të shoqërisë civile, media, etj.